



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 1/127

Datë: 01.06.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 01 qershor 2010, mori

**V E N D I M**

1. Të gjitha pronat publike të paluajtshme brenda korridorit, trasesë së autostradës Vërmicë-Merdarë barten në pronësi të Qeverisë së Kosovës.
2. Obligohen të gjitha autoritetet përgjegjëse që të pezullojnë dhe ndalojnë çdo aktivitet dhe procedurë që është duke u zhvilluar në tjetërsimin e pronës publike të paluajtshme.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen të gjitha autoritetet përgjegjëse të cilat kanë kompetenca në ushtrimin e të drejtave pronësore, përfshirë këtu edhe procesin e privatizimit.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 2/127

Datë: 01.06.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 01 qershor 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Programi Kombëtar i Shkencës i Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që programin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 3/127

Datë: 01.06.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 01 qershor 2010, mori

**V E N D I M**

1. Themelohet Këshilli Ndërmintor për Politika Tregtare në përbërje të këtyre ministrave:
  - Z. Lutfi Zharku, Ministër i Tregtisë dhe Industrisë;
  - Z. Fatmir Limaj, Ministër i Transportit dhe Postë-telekomunikacionit;
  - Z. Blerand Stavileci, Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
  - Z. Ahmet Shala, Ministër për Ekonomi dhe Financa;
  - Z. Besim Beqaj, Ministër i Integritimit Evropian;
  - Znj. Edita Tahiri, Ministre e Administratës Publike;
  - Z. Skënder Hyseni, Ministër i Punëve të Jashtme.
2. Këshilli udhëhiqet nga Ministri i Tregtisë dhe Industrisë dhe drejton politikat tregtare të Republikës së Kosovës në lidhje me tregtinë ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 4/127

Datë: 01.06.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 01 qershor 2010, mori

**V E N D I M**

**Për plotësimin e Strategjisë Legjislative të vitit 2010 të Qeverisë së Republikës së Kosovës**

1. Në Strategjinë Legjislative të vitit 2010 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të përfshihen:
  - 1.1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048, për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit;
  - 1.2. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 177 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010;
  - 1.3. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.
2. Bartës i hartimit të projektligjeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, është Ministria e Ekonomisë dhe Financave.
3. Ngarkohet Zyra për Shërbimet e Ndihmës Juridike në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 5/127

Datë: 01.06.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 01 qershor 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Plani i Ministrisë së Punëve të Brendshme për shtimin e orarit ditor të punës në 11 orë dhe aplikimi i orarit 8 orësh të punës të shtunave në Agjencionin e Regjistrimit Civil, me qëllim të realizimit të programit "Diaspora 2010".
2. 410 punëtorët të cilët do të punojnë me orar të shtuar, do të realizojnë të ardhura mujore shtesë, në vlerë prej 200 euro në muaj.
3. Programi "Diaspora 2010" fillon të aplikohet nga 01 qershori 2010 dhe përfundon më 30 shtator 2010.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe Ministria e Administratës Publike.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 6/127

Datë: 01.06.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 01 qershor 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet Kërkesa e Kompanisë "Bechtel-Enka" nr. 115, e datës 21.05.2010, lidhur me zgjatjen e orarit javor të punës për punëtorët e angazhuar përkohësisht në ndërtimin e Autostradës Morinë-Prishtinë-Merdare.
2. Zgjatja e orarit javor të punës bëhet në pajtim të plotë me vullnetin e punëmarrësit dhe punëdhënësit, gjithherë duke pasur parasysh se është në pyetje një projekt i rëndësisë nacionale për Republikën e Kosovës.
3. Kompensimi për orët shtesë, jashtë orarit të plotë punës për punëtorët e angazhuar në këtë projekt, do të bëhet në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm nga marrëdhënia e punës.
4. Ky vendim do të aplikohet deri në hyrjen në fuqi të Ligjit të Punës së Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë